



# **BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS**

Nëntor 2021

# BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Nëntor 2021

## AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

**(Në edicionin e përmuajshëm të këtij buletini pasqyrohen aktivitetet për muajin nëntor të vitit 2021)**

### Mbahet Takimi i 205-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Këshilli Prokurorial i Kosovës ka mbajtur takimin e 205-të me radhë, në të cilën anëtarët e KPK-së miratuan Rregulloren për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve dhe Plotësimndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr. 01/2018 për Caktimin e Normës Orientuese për Prokurorët e Shtetit.



Gjithashtu miratuan Dokumentin e politikave të trajnimit për prokurorët dhe stafin administrativ të sistemit prokurorial dhe Planin e nevojave për trajnimin e prokurorëve dhe stafit administrativ. Këto dy dokumente do të dërgohen në Akademinë e Drejtësisë dhe do të jenë bazë për hartimin e programeve trajnuese për sistemin prokurorial për vitin 2022.

Takimi vazhdoi me avancimin e një prokurori në Prokurorinë e Apelit, dy prokurorëve në Departamentin e Krimeve të Rënda në Prokurorinë Themelore të Gjilanit dhe një prokurori në Departamentin e Krimeve të Rënda në Prokurorinë Themelore të Gjakovës.

Po ashtu është miratuan pjesërisht edhe Raportin për vlerësimin e performancës së tetë prokurorëve të shtetit.

Këshilli ka marrë vendim për rishpalljen e Konkursit të brendshëm për avancimin e një prokurori në

Departamentin për të Mitur të Prokurorisë Themelore të Gjakovës.

Në fund të takimit, anëtarët e KPK-së kanë themeluar dy panele hetimore për trajtimin e dy rasteve disiplinore - një në Prokurorinë Themelore të Prishtinës dhe një në Prokurorinë Themelore të Ferizajt.

### Grupit punues ka hartuar draftin e parë të Rregullores për zgjedhjen e drejtorit të SKPK-së dhe NJSHPP-së

Grupi punues për hartimin e draftit të Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e Drejtorit të SKPK-së dhe të NJSHPP-së mbajti takim e radhës, në të cilin morën pjesë edhe partnerët ndërkombëtarë dhe përfaqësuesi i Grupit për Studime Juridike dhe Politike. Në takim është punuar në draftin fillestar të Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e Drejtorit të SKPK-së dhe NJSHPP-së, kurse, gjatë punës, me komentet e tyre kanë marrë pjesë edhe partnerët ndërkombëtarë dhe shoqëria civile.



### Deklaratë nga Këshilli Prokurorial i Kosovës

Këshilli Prokurorial i Kosovës ka reaguar përmes një deklarate, duke thënë se nuk do të marrë pjesë në Grupin punues të Ministrisë së Drejtësisë për hartimin dhe finalizimin e legjislacionit për procesin e vetingut në sistemin e drejtësisë, sepse Ministria e Drejtësisë e ka proceduar në Qeveri draftin final për procesin e vetingut pa u konsultuar fare me institucionet e pavarura të drejtësisë.



### Promovimi i të drejtave të viktimave të krimit, prioritet institucional

Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës mbajti takim me Menaxherin e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave dhe udhëheqësit e zyrave regjionale të mbrojtësve të viktimave, i cili ka pasur në fokus diskutimin e temave, që ndërlidhen me proceset e punëve dhe sfidat e mbrojtësve të viktimave.



### Maloku dhe Burrows diskutojnë për proceset e mbështetjes dhe avancimit të shërbimeve prokuroriale

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës priti në takim Drejtoreshën Operative të Projektit britanik "Forcimi i sistemit të drejtësisë në Kosovë".



Kryesuesi Maloku dhe Drejtoresha Burrows shprehën përkushtimin e tyre për të intensifikuar edhe më tej bashkëpunimin lidhur me gjetjen e mënyrave dhe formave më efikase të punës dhe për trajtimin e kërkesave, nevojave, sfidave dhe vështirësive, që mund të paraqiten në të ardhmen.

### Sqarim nga Këshilli Prokurorial i Kosovës

KPK-ja sqaroi opinionin publik se vendimi që obligon kryeprokurorët dhe prokurorët që t'i njoftojnë mbikëqyrësit e tyre të drejtpërdrejtë, përkatësisht

Kryeprokurorin e Shtetit dhe Kryesuesin e Këshillit Prokurorial, lidhur me komunikimin me përfaqësuesit e pushteteve të tjera, ka për qëllim respektimin e plotë të hierarkisë institucionale dhe funksionimin e sistemit prokurorial në mënyrë sa më të koordinuar dhe efikase.



### Kryesuesi Maloku priti në takim Ambasadorin e Misionit të OSBE-së, Davenport

Kryesuesi i KPK-së priti në takim Shefin e Misionit të OSBE-së në Kosovë, qëllimi i të cilit ishte mbajtja e vazhdimësisë së komunikimit në mes dy institucioneve, thëllimi i bashkëpunimit dhe diskutimi i mbështetjes konkrete të OSBE-së për sistemin prokurorial të Kosovës.



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian dhe sistemi prokurorial i Kosovës bashkëpunojnë përmes projekteve dhe memorandumeve të ndryshme, me qëllim të ngritjes së efikasitetit, efektivitetit, komunikimit dhe transparencës së sistemit prokurorial.

### Analizohet realizimi i Javës për të Drejtat e Viktimave të Krimit

Grupi punues për organizimin e Javës për të Drejtat e Viktimave të Krimit mbajti takim për të analizuar ecurinë e kësaj jave, në të cilin u diskutua se si të vepronet në të ardhmen dhe çfarë duhet të bëhet edhe më mirë për të dërguar mesazhin e duhur që viktimat

e krimit të trajtohen me prioritet dhe pa vonesa, por edhe të bëhet një sensibilizim më i madh i opinionit të gjerë.



### Mbahet Testi Kualifikues i kandidatëve për 16 prokurorë të shtetit

Në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri është mbajtur Testi Kualifikues i kandidatëve në kuadër të procesit të rekrutimit të 16 prokurorëve në prokuroritë themelore, ku morën pjesë 277 kandidatë.



Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka mbikëqyrur mbarëvajtjen e Testit Kualifikues në cilësinë e Kryetarit të Komisionit për Rekrutim së bashku me anëtarët e tjerë të këtij komisioni, me ç'rast gjatë fjalës së rastit iu ka urrear suksese kandidatëve në këtë proces rekrutues, si dhe Kryesuesi i KPK-së, Jetish Maloku.



## Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Akademia e Drejtësisë nënshkruajnë memorandum mirëkuptimi

Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Akademia e Drejtësisë nënshkruan Memorandum të mirëkuptimit për trajnimet e detyrueshme dhe trajnimet shtesë për prokurorë.



Fushëveprimi i këtij memorandumi përfshin trajnimin për prokurorët, të cilët vlerësohen me performancë të pakënaqshme dhe për këtë arsye rekomandohen për trajnim të detyrueshëm dhe trajnim shtesë.

## Diskutohet intensifikimi i bashkëpunimit të KPK-së me Agjencinë për Informim dhe Privatësi

Kryesuesi i KPK-së priti në takim Komisioneren e Agjencisë për Informim dhe Privatësi, qëllimi i të cilit ishte diskutimi për fuqizimin e frymës së bashkëpunimit dhe marrjen e mendimeve dhe këshillave për avancimin e procedurës për qasje në dokumente publike dhe mbrojtjen e privatësisë respektivisht zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.



## Trajtimi i lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike të jetë prioritet i Prokurorisë Themelore të Prizrenit

Grupi punues për mbikëqyrjen e Njësitit për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike vizitoi Prokurorinë Themelore të Prizrenit.



Në këtë takim u kërkua një përkushtim më i madh në zvogëlimin e numrit të lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike dhe trajtimin e tyre me prioritet të lartë.

## Mbahet takimi i dytë për hartimin e Rregullore për sistematizimin e administratës në sistemin prokurorial

Grupi punues për hartimin e Rregullore për veprimtarinë, organizmin e brendshëm dhe sistematizimin e administratës në sistemin prokurorial të Kosovës mbajti takimin e dytë me radhë, në të cilin morën pjesë edhe përfaqësuesit ndërkombëtare dhe ata të shoqërisë civile, ku u thas se qëllimi i hartimit të kësaj rregulloreje është funksionalizimi dhe riorganizimi i administratës së sistemit prokurorial të Kosovës, akt nënligjor ky, i cili do të përcaktojë formën, strukturën, kompetencat dhe veprimtarinë e administratës së Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Prokurorit të Shtetit.



## Mbahet takimi i radhës i Komisionit për Administrimin e Prokurorive

Në takimin e Komisionit për Administrimin e Prokurorive u prezantua Raporti i Prokurorisë Themelore të Gjakovës për hapat e ndërmarrë për harmonizimin e regjistrave të statistikave, të cilat raportohen nga Shkrimorja dhe ato që raportohen nga prokurorët. Në këtë aspekt, u tha se deri në fund të këtij viti do të angazhohen personat kompetentë për përmirësimin eventual të këtyre të dhënave.



## Kryesuesi Maloku takohet me ekspertët e Projektit EUKOJUST

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës priti në takim Ekspertin Afatshkurtër të Projektit EUKOJUST, i cili është përgjegjës për koordinimin e donatorëve në sektorin e sundimit të ligjit, ku u diskutua për krijimin e një mekanizmi koordinues të donatorëve në sistemin e drejtësisë dhe koordinimin me sektorët e tjerë përkatës.



## EULEX-i dhuron pajisje teknologjike për sistemin prokurorial

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë dhuroi një donacion me pajisje teknologjike për sistemin prokurorial të Kosovës, i cili përbëhet nga një numër i kompjuterëve, monitorëve, telefonave dhe

pajisjeve tjera, të cilat do të shërbejnë për nevojat e punës së stafit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Prokurorit të Shtetit.

Pranimdorëzimi i këtij donacioni është bërë nga Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Shefi i Stafit të EULEX-it.



## Mbahet punëtori për prezantimin e Drafttregullore për organizmin e brendshëm dhe funksionimin e Prokurorit të Shtetit

KPK-ja, e mbështetur nga Programi i BE-së për Sektorin e Drejtësisë në Kosovë, EUKOJUST, organizoi një punëtori, në të cilën morën pjesë kryesuesi Maloku, kryeprokurorë të prokurorive, prokurorë të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, përfaqësues të projektit EUKOJUST, anëtarë të Komisionit për Çështje Normative, anëtarë të grupit për hartimin e këtij drafti dhe udhëheqës njësisish nga radhët e administratës së sistemit prokurorial të Kosovës, qëllimi i të cilës ishte prezantimi dhe diskutimi i organizmit të brendshëm dhe funksionimin e Prokurorit të Shtetit, përfshirë diskutimin e drafteve të organogramëve të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Prokurorisë së Apelit, Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe prokurorive themelore të vendit.



## Kryesuesi i KPK-së priti në takim Ambasadorin e Norvegjisë

Kryesuesi i KPK-së priti në takim Ambasadorin e Norvegjisë në Kosovë, të cilin e njoftoi për të arriturat e sistemit prokurorial të Kosovës në fushën e zbatimit të sistemit për menaxhimin informativ të lëndëve, përgatitjen e akteve nënligjore, procesin e vlerësimit të prokurorëve, procesin e rekrutimit të prokurorëve, por edhe për sfidat me të cilat po përballemi duke përfshirë edhe ato ligjore.



## Aktivitetet e Sekretariatit të KPK-së

Sekretariati i KPK-së, gjatë muajit nëntor, zhvilloi një sërë procesesh të punës, ndër të cilat veçojmë procesin e përgatitjes së propozimeve për përkrahje me projekte nga IPA 2023-2024 dhe mbajtjen e takimeve me ekspertët e projektit EUKOJUST lidhur me strukturimin e Planit Strategjik të sistemit prokurorial dhe publikoi Raporti i avancuar nga sistemi për menaxhimin informativ të lëndëve, i cili paraqet në detaje punën e prokurorëve dhe prokurorive.

Në veçanti, SKPK-ja ka qenë e anguzhuar në mbështetjen e organizimit të Testit Kualifikues për prokurorë,

Po ashtu në pajtim me Rregulloren e Dosjes së Prokurorëve ka koordinuar procesin e pranimit dhe dorëzimit të dosjeve të prokurorëve, me ç'rast janë krijuar 184 dosje prokurorësh.

Gjithashtu është ndjekur "Trajnimi hyrës për nëpunësit e ri civil në Shërbimin Civil të Kosovës", të organizuar nga IKAP-I. Po ashtu, stafi administrativ mori pjesë në punëtorinë për dizajnimin organizativ të KPK-së, i përkahur nga projekti EUKOJUST dhe në dy punëtori të tjera për zyrtarët financiarë dhe zyrtarët për komunikim publik, të cilin e ka organizuar nga Ambasada Amerikane në Prishtinë.

Ndërkohë, SKPK-ja mbështeti finalizimin e draftit të Rregullosës për menaxhimin e procesit të punës përmes

Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve në sistemin prokurorial të Kosovës.

Nga ana tjetër, vlen të theksohet se në bashkëpunim me Konsorciumin e Projektit SMIL është bërë testimi i SMIL-it për Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit për lëmin penal.

## Aktivitetet e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë

Njësi për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë ka qenë i përqendruar në zbatimin e procesit të transferimit të dosjeve të prokurorëve nga NJSHP-ja te Divizioni i Burimeve Njerëzore, siç përcaktohet me Rregulloren për Dosjen Personale të Prokurorëve, proces ky, i cili është përfunduar.

Gjithashtu, NJSHP-ja, ka hartuar Raportin nëntëmujor të punës së Prokurorit të Shtetit dhe ka mbështetur organizimin i Testit Kualifikues për prokurorë dhe ka pasur mbështetje administrative gjatë tërë procesit të rekrutimit, si dhe hartimin e Raportit për harmonizimin dhe përputhshmërinë e shënimeve statistikore të raporteve të Shkrimores dhe prokurorëve në prokuroritë themelore në Pejë dhe Gjiilan, pastaj hartimin e Raportit krahasues për numrin e lëndëve të dhunës në familje për tremujorin e tretë 2021.

NJSHP-ja gjatë këtij muaji ka bashkëkoordinuar trajnime të shumta për prokurorë dhe stafin administrativ, ndër të cilat veçojmë ato të mbajtur në platformën elektronike Zoom: Punëtorinë për hartimin e Programit trajnues për vitin 2022; Punëtorinë e dytë për hartimin e Procedurave Standarde të Veprimit për hetimin e rasteve të punës së rënda të fëmijëve; Programin e specializuar të trajnimit "Krimi Kibernetik – Sesioni III", si dhe trajnimet: "E drejta në mjetin juridik efektiv - neni 13 i KEDNJ"; "Procedura penale e kryerësve me çrregullime mendore", "E drejta për barazi dhe mosdiskriminim"; "Nxitja e urrejtjes, e përçarjes ose e mosdurimit kombëtar, racor, fetare ose etnik"; "Shqyrtimi gjyqësor te kryesit e mitur të veprave penale"; "Mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të dëmtuar (viktimave), si dhe dëshmitarëve bashkëpunues"; "Procedura administrative që nga shpallja e tenderit deri te vendimmarrja e OSHP"; "Avancimi mbi të drejtat e personave LGBTI në Kosovë"; "Menaxhimi i punës në administratën e sistemit prokurorial" dhe "Menaxhimi kohës dhe stresit".

Ndërkohë, NJSHPP-ja ka përpiluar edhe raportet për Gjithashtu në mënyrë sistematike janë përcjellë dhe koordinuar trajnimet e zhvilluara në kuadër të Programit të Trajnimeve të Vazhdueshme, si në vijim: